



Prishtinë: 24.03.2010

Kodi i ZRRE-së: V_237_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_347_02_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_347_02_10** ;
5. Apeli i e konsumatorit me datë 26.02.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, dhe
7. Rregullën për shqycje dhe rikycje të konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë;

Në mbledhjen e mbajtur më 24 mars 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Agim Beqiri (shifra e konsumatorit DPR – 90030338) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 21.12.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 03.12.2009 lidhur me kontestimin e njoftimit për shqycje dhe shqycjes

- Me datë 29.05.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar njoftimin për shqycje dhe shqycjen nga ana e KEK-ut
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 03.12.2009 Departamenti për Konsumatorë në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se njoftimet për shqycje dhe shqycjet e realizuara kanë arritur si rezultat i borxhit të energjisë elektrike ndaj ndërmarrjes së energjisë.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 03.12.2009
- Me datë 24.11.2004 konsumatori ka nënshkruar me KEK-un Kontratën për rregullimin e borxhit të energjisë elektrike.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 25.02.2006, KEK-u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shqycje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ka qenë 940.86 €.
Provë: Transaksionet e konsumatorit

- Me datë 14.07.2006, KEK-u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ka qenë 1,056.35 €. **Provë:** Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 04.10.2006, punëtorët e KEK-ut e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik konsumatorin për shkak se nuk iu është përmbajtur kërkesave sipas njoftimit për shkyçje. Me realizimin e shkyçjes nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 115.00 €. **Provë:** Urdhëresa për shkyçje dhe transaksionet e konsumatorit
- Me datë 19.10.2006, punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe se kanë vërejtur se konsumatori është rikyçur ilegalisht në rrjetin elektrik pa lejen e askujt dhe e kanë shkyçur prapë nga rrjeti elektrik. Me realizimin e shkyçjes së dytë nga ekipet e KEK-ut konsumatori është ngarkuar me taksën për shkyçje në vlerë 345.00 €. **Provë:** Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 19.12.2006, KEK-u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ka qenë 1,629.26 €. **Provë:** Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 01.12.2007, KEK-u i ka dërguar konsumatorit njoftimin për shkyçje për shkak të borxhit që ka ndaj KEK-ut, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ka qenë 1,742.45 €. **Provë:** Transaksionet e konsumatorit
- Me datë 11.02.2010 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se të gjitha njoftimet për shkyçje dhe shkyçjet e bëra nga ana e KEK-ut ndaj konsumatorit kanë qenë në pajtim me Rregullën për shkyçje dhe rikyçje të konsumatorëve në sektorin e energjisë, përveç në dy raste (data 14.07.2006 dhe 01.12.2007) kur KEK-u e ka njoftuar konsumatorin për shkyçje pa të drejt. **Provë:** Vendimi i DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_347_02_10
- Me datë 21.12.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_347_02_10. **Provë:** Ankesa e konsumatorit në Bord të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_347_02_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar